



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Kolegji "BIZNESI"



Komuna e Dragashit

KOLEGJI "BIZNESI"
4/8/20 Data: 23.11.20
PRIZREN

**Memorandum bashkëpunimi
në mes të
Kolegji "BIZNESI" Prishtinë
dhe
Komunës së Dragashit**

Me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes të Kolegjit BIZNESI Prishtinë, dhe Komunës së Dragashit, me pikësynim përkrahjen e ngritjes së nivelit edukativ dhe profesional të rinjeve Kosovare, si dhe krijimin e një ambienti më të volitshëm ekonomik dhe për të konkurruar në projekte të ndryshme të përbashkëta të përkrahura nga AER-i, USAID-i, Banka Botërore, Institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, Institucione dhe shoqata profitabile dhe joprofitabile, Kolegji BIZNESI Prishtinë dhe Komuna e Dragashit, lidhin këtë memorandum të mirëkuptimit dhe pajtohen të zhvillojnë bashkëpunim në këtë lëmi.

I. Natyra e bashkëpunimit

Qëllimi

1. Kolegji BIZNESI Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm BIZNESI) dhe Komuna e Dragashit (në tekstin e mëtejshëm KOMUNA), pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik.
2. Kolegji BIZNESI Prishtinë dhe Komuna e Dragashit, së bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, ofrimit të shërbimeve për këtë subjekt edukativ, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë. Në këtë aspekt Kolegji BIZNESI do t'iu ofrojë ndihmë anëtarëve të Komunës së Dragashit me shërbimet e veta.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Kolegji "BIZNESI"



Komuna e Dragashit

3. Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social në Kosovë, hartimin e analizave makronomike, në mënyrë të rregullt të paraqesin ofertën e përbashkët dhe të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve.
4. Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit si partner të përbashkët mund të hyjnë veç e veç në raporte kontraktuese me partner të tjerë dhe mund të mbështesin anëtarët dhe klientët e partnerëve si dhe projektet e tyre me qëllim të krijimit të një partneriteti të frytshëm dhe kooperues në mes tyre.

II. Emërtimi i shërbimeve

1. Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit pajtohen që për nevojat e tyre të shkëmbejnë ekspertët dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara ekonomike si dhe që studentët e lëmive ekonomike, juridike dhe emergjencave, pranë këtij Kolegji të kryejnë praktikën në Komunën e Dragashit. Gjithashtu Komuna e Dragashit do të mundësojë – angazhojë praktikën e studentëve në komunë dhe në bizneset e kësaj komune.
2. Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit së bashku do të kontribuojnë në drejtim të krijimit të partneritetit dhe integritit evropian të komunitetit kosovar në raportet ndërkombëtare.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Ky memorandum i mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë afat të pakufizuar, përderisa njëra palë me shkrim nuk e njofton palën tjetër 6 (gjashtë) muaj më parë, për ndryshimet eventuale.
2. Ky Memorandum i Mirëkuptimit nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe për secilën palë përgatitet nga një kopje origjinale.
3. Për çdo vit akademik, Komuna e Dragashit do të përcaktojë numrin e studentëve që do të aftësohen nëpërmjet punës praktike.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



Kolegji "BIZNESI"

Komuna e Dragashit

4. Kolegji BIZNESI do t'i dorëzojë për çdo vit akademik partnerit listën me emrat e studentëve të përzgjedhur dhe të paraparë për aftësimin praktik në Komunën e Dragashit.
5. Praktika e studentëve të Kolegjit BIZNESI në Komunën e Dragashit, do të zgjasë prej dy javë deri në një muaj. Kohëzgjatjen e praktikës, partnerët e caktojnë me marrëveshje gojore dhe nga rasti në rast.

IV. Komunikimi/Avokimi dhe Marketingu Strategjik

1. Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit do të punojnë bashkërisht për promovimin e nismave të përbashkëta, për thellimin e marrëdhënieve me publikun, për krijimin e mundësive për paraqitjet e përbashkëta në publik dhe për promovimin e ndërsjellë të iniciativave.
2. Të dy entitetet juridike, Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit, obligohen që në paraqitjet e tyre publike, sa here që diskutojnë iniciativat e përbashkëta, si këto të kryerjes së praktikës të studentëve, të aftësimit dhe punësimit të tyre, do t'i referohen punës së përbashkët dhe partnerit, pavarësisht nëse është apo nuk është i pranishëm ai.
3. Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit obligohen që me rastin e fillimit por edhe të përfundimit të nismave, si punësimit dhe aftësimit nëpërmjet punës praktike të studentëve, të zhvillojnë materialet e përbashkëta promovuese, siç janë komunikatat për shtyp, konferencat, e të ngjashme. Komunikatat e përbashkëta do të përmbajnë logot e të dyjave palëve nënshkruese të marrëveshjes, të Kolegji BIZNESI dhe Komuna e Dragashit. Përmbajtjet e publikimeve promovuese do të publikohen në web faqet e të dy entiteve.

Kolegji BIZNESI

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi,


Dekan



Komuna e Dragashits

Shaban Shabani,

Kryetar i Komunës së Dragashit



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/01-23018/20

23. 11. 20 20
Dragash - Dragaš